



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2022, merr këtë

V E N D I M

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të: Valbone (Shaip) Mërkoja, Naser (Shaip) Mërkoja, Fatmir (Shaip) Mërkoja dhe Ragip (Shefki) Selimi.
- II.** Vendimi i cekur në pikën I nënkupton këtë këmbim:
1. Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, janë parcelat nr. 06926-2, me sipërfaqe prej: 23m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-06926-2, 06926-3, me sipërfaqe prej: 29m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-06926-3, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Ragip (Shefki) Selimi, parcela nr. 06932-2, me sipërfaqe prej: 63m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-06932-2, në pronësi të Valbone (Shaip) Mërkoja, Naser (Shaip) Mërkoja, Fatmir (Shaip) Mërkoja, dhe 06933-2, me sipërfaqe prej: 6m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-06933-2, në pronësi të Valbone (Shaip) Mërkoja, me destinim "interes publik - rrugë, sipas Planit rregullues "Muhaxhirët", të miratuar me Vendimin e KK-së së Prishtinës, 01. nr. 035-1299, dt. 29.06.2013 dhe Plani zhvillimor urban "Muhaxhirët", i miratuar me Vendimin 01. nr. 035-181427, dt. 24.09.2013.
 2. Kurse prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesa e parcelës nr. 07751-0, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-07751-0, dhe 07752-1, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-07752-1, Zona kadastrale Prishtinë, me destinim shtrihet brenda vijës rregulluese, ndërtim sipas Planit rregullues "Muhaxhirët", të miratuar me Vendimin e KK-së së Prishtinës, 01. nr. 035-1299, dt. 29.06.2013 dhe Plani zhvillimor urban "Muhaxhirët", i miratuar me Vendimin 01. nr. 035-181427, dt. 24.09.2013.
- III.** Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë, pasi që prona e lartcekur shfrytëzohet për interes publik dhe kostoja financiare e shpronësimit është shumë e lartë.
- IV.** Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V.** Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelave kadastrale që do të këmbehen.

- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- skica grafike,
 - kopjet e planit dhe
 - certifikatat e njësisë kadastrale.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/03-177511/22, më 26.07.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Arsyetim

Pronari i pronës private, sipas kërkesës nr. 13-464/01-83962/22, ka kërkuar që të kompensohet për pronën private, e cila shfrytëzohet për interes publik – rrugë, gjegjësisht është parcela nr. 06926-2, me sipërfaqe prej: 23m², 06926-3, me sipërfaqe prej: 29m², 6932-2, me sipërfaqe prej 63m² 6933-2, me sipërfaqe prej 6m², Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Valbone (Shaip) Mërkoja, Naser (Shaip) Mërkoja, Fatmir (Shaip) Mërkoja dhe Ragip (Shefki) Selimi, me destinim “interes publik – rrugë”, sipas Planit rregullues “Muhaxhirët”, të miratuar me Vendimin e KK-së së Prishtinës, 01. nr. 035-1299, dt. 29.06.2013 dhe Planin zhvillimor urban “Muhaxhirët”, i miratuar me Vendimin 01. nr. 035-181427, dt. 24.09.2013.

Propozimi për inicimin e këmbimit të pronës komunale me pronën private të cekur në pikën II, është bërë për arsyet se prona e lartcekur shfrytëzohet për interes publik, dhe kostoja financiare e shpronësimit është shumë e lartë, andaj për t’u shmangur pasojat e larta financiare që mund të vijnë nga proceset gjyqësore, është propozuar që prona e lartcekur të këmbëhet me pronën komunale, gjegjësisht me pjesën e parcelës nr. 07551-0 dhe 07752-1, Zona kadastrale Prishtinë, me destinim shtrihet brenda vijës rregulluese ndërtim sipas Planit rregullues “Muhaxhirët”, të miratuar me Vendimin e KK-së së Prishtinës, 01. nr. 035-1299, dt. 29.06.2013 dhe Plani zhvillimor Urban “Muhaxhirët” i miratuar me Vendimin 01. nr. 035-181427, dt.24.09.2013.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.